

REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO-POLJE
Drejtori i Administratës dhe Drejtori i Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale
Nr. 62
Datë: 29.04.2016
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO-POLJE



**REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA**



**KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE**

Datë: 29.04.2016

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 29.04.2016, pas shqyrtimit të Propozimit Nr. 337, të datës 20.04.2016, paraqitur nga Drejtoria e Administratës dhe Drejtoria e Shëndetësisë e Mirëqenies Sociale, të shqyrtuar në Komitetin për Politikë e Financa dhe Komitetin për Komunitete, bazuar në Nenin 40, paragrafi 40.2, shkronja (c), të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), Nenin 27, shkronja (ç), të Statutit të Komunës, Nr. 98, i datës 17.08.2012, mori:

V E N D I M

1. Për lejimin e mjeteve financiare në shumë prej 8,600.00€, me destinim për mbulimin e shpenzimeve të transportit, ushqimit dhe fjetjes nga organizimi i vizitës së punëtorëve të Shërbimit Civil të Administratës së Komunës dhe punëtorëve të Institucioneve Shëndetësore Publike të Komunës në Republikën e Shqipërisë për festat e muajit Maj.
2. Është në kompetencë të Drejtorisë së Financave e Buxhetit që të siguroj mjetet financiare nga buxheti i Komunës sipas pikës një (1) të vendimit.
3. Kryerja dhe mbikëqyrja e procedurave të destinimit të mjeteve financiare është në kompetencë të Kryetarit të Komunës, Drejtorisë së Financave e Buxhetit, Drejtorisë së Administratës dhe Drejtorisë së Shëndetësisë e Mirëqenies Sociale.
4. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e komunës.

Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesuesit të Kuvendit të Komunës, Drejtorisë së FB, Drejtorisë së Administratës, Drejtorisë së SHMS dhe Arkivës.



**Kryesuesi i Kuvendit të Komunës
Mr. Fadil Krasniqi**



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO-POLJE
DREJTORIA E ADMINISTRATËS - DIREKCIJA ZA ADMINISTRACIJU

Nrfaq/Bestr. 63
Data/Date: 10. 05. 2016
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO-POLJE

Datë: 06.05.2016

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 29.04.2016, pas shqyrtimit të Propozimit Nr. 306, të datës 14.04.2016, paraqitur nga Drejtoria e Arsimit, të shqyrtuar në Komitetin për Politikë e Financa dhe Komitetin për Komunitete, bazuar në nenin 17, shkronja (h), nenin 40, paragrafi 40.2, shkronja (c, l), të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 6, nenin 7 dhe nenin 19, të Ligjit për arsimin dhe aftësimin për të rritur Nr. 04/L-143 (Gazeta Zyrtare 02/2013), nenin 12, paragrafi 12.1, shkronja (ë), nenin 27, shkronja (ç, nj), të Statutit të Komunës, Nr. 98, i datës 17.08.2012, mori:

V E N D I M

1. Aprovohet propozimi për hapjen e linjës buxhetore në kategorinë ekonomike 11 për 'Rroga dhe paga'.
2. Mjetet financiare, në shumë të përgjithshme prej 19,051.00€, si të hyra vetjake në arsim, destinohen për pagesat e arsimtarëve dhe stafit arsimor që kanë zhvilluar dhe zhvillojnë procesin mësimor, mbajtjen e provimeve nga mësimi joformal dhe alokohen në kategorinë ekonomike 11 në arsimin e mesëm si vijon: në arsim të mesëm për Shkollën e Mesme Teknike 'Minatori', kodi i programit Nr. 94231, shuma prej 6.668.00€ dhe në arsim të mesëm për Shkollën e Mesme Ekonomike 'Hoxhë Kadri Prishtina', kodi i programit Nr. 94232, shuma prej 12,383.00€.
3. Kryerja dhe mbikëqyrja e procedurave tjera është në kompetencë të Drejtorisë së Financave e Buxhetit dhe Drejtorisë së Arsimit.
4. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesuesit të Kuvendit të Komunës, Drejtorisë së FB, Drejtorisë së Arsimit dhe Arkivës.



Kryesuesi i Kuvendit të Komunës
Mr. Fadil Krasniqi

REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
OPŠTINA KOSOVO-POLJE
OFICINA E ADMINISTRATËS - OFIS ZA ADMINISTRACIJU
Fushë-Kosovë
Nr. 64
10.05.2016
Fushë-Kosovë



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE

Datë: 06.05.2016

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 29.04.2016, pas shqyrtimit të Propozimit Nr. 348, të datës 26.04.2016, paraqitur nga Kryetari i Komunës, të shqyrtuar në Komitetin për Politikë e Financa dhe Komitetin për Komunitete, bazuar në nenin 40, paragrafi 40.2, shkronja (l), të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 27, shkronja (nj), nenin 48 të Statutit të Komunës, Nr. 98, i datës 17.08.2012, nenin 52, nenin 55, të Rregullores për Organizimin, Kompetencat dhe Përgjegjësitë e Organeve të Administratës Komunale, Nr. 125, të datës 25.09.2014, nenin 1, nenin 6, paragrafi 2 dhe nenin 9 paragrafi 1, pika 1.3, të Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve Nr. 83 të datës 14.06.2013 mori:

V E N D I M

1. Për lejin e mjeteve financiare në shumë prej 20,000.00€, për Klubin e Futbollit "Fushë-Kosova", për t'i ndihmuar në mbulimin e shpenzimeve për pjesëmarrjen në Kampionatin e Futbollit të Ligës së Parë të Kosovës në Futboll, për sezonin pranveror 2015-2016 dhe sezonin vjeshtor 2016-2017.
2. Është në kompetencë të Drejtorisë për Financa dhe Buxhet që të sigurojë mjetet financiare sipas pikës një (1) të vendimit.
3. Obligohet Klubi i Futbollit "Fushë-Kosova" që për mjetet e lejuara financiare, sipas pikës një (1) të vendimit, t'i raportojë me shkrim Kuvendit të Komunës.
4. Kryerja e procedurave tjera dhe mbikëqyrja e destinimit të mjeteve financiare është në kompetencë të Kryetarit të Komunës, Drejtorisë së Kulturës, Rinisë e Sportit dhe Drejtorisë së Financave dhe Buxhetit.
5. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e komunës.

Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesuesit të Kuvendit të Komunës, Drejtorisë së FB, Drejtorisë së KRS dhe Arkivës.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës
Mr. Fadil Krasniqi

